



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.4.2023

Nr: 244

Ora: 16:00

VENDIM

PËR

**SHYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E LISTËS SHUMEMËRORE TË KËSHILLIT BASHKIAK,
BASHKIA TIRANË, TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR "LËVIZJA BASHKË", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET
E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 3.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën:

KËRKUES: Partia "Lëvizja Bashkë" me shkronja nistore "BASHKË"

OBJEKTI: Miratimi i listës shumëmeore të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, të subjektit zgjedhor "Lëvizja Bashkë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, nenet 67, 72 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023 "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", dhe të shkronjës "a", të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Data: 3.4.2023 Nr: 244
Ora: 16:00



"Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listës shumëmeore, të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, të subjektit zgjedhor "Lëvizja Bashkë" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

VËREJ:

Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Me vendimin nr. 192, datë 23.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, partia “Lëvizja Bashkë” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbështetje të neneve 67, 68 pika 2 dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti zgjedhor partia “Lëvizja Bashkë”, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listës shumëmemërore si dhe firmat mbështetëse për zonën zgjedhore.

Neni 68 pika 2, i Kodit Zgjedhor, përcakton se *“Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 përqind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3,000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës”*.

Referuar ekstraktit më të fundit të listës së zgjedhësve rezulton se zona zgjedhore Bashkia Tiranë ka 699 748 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë) zgjedhës. Sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 68 të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, numri i zgjedhësve që i korrespondon kufirit minimal prej 1% të listës së zonës zgjedhore Bashkia Tiranë është 7000 (shtatë mijë). Nga subjekti zgjedhor partia “Lëvizja Bashkë” janë depozituar 3,500 firma mbështetëse sipas përcaktimeve ligjore.

Ne referim të nenit 71 pika 3, administrata e KQZ-së ka verifikuar 5 përqind të listës mbështetëse të kërkuar sipas ligjit për zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, si dhe nëse personat që kanë nënshkruar janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit të tyre.

Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listën shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkinë Tiranë, të subjektit zgjedhor partia “Lëvizja Bashkë” dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenet 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkinë Tiranë, të subjektit zgjedhor, partia “Lëvizja Bashkë” kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si

organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik.

Nga verifikimi *prima facie* i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak rezulton se, të gjithë kandidatët e listës shumemërore nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, nëpërmjet postës elektronike ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me anë të komunikimit elektronik në datën 29.3.2023 ka dërguar verifikimin e të dhënave për të gjithë kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, dhe përkatësisht për Bashkinë Tiranë, të subjektit zgjedhor, partia “Lëvizja Bashkë” sipas së cilës rezulton se;

1. Kandidatët e propozuar në listën shumemërore nga partia “Lëvizja Bashkë” për këshillin bashkiak **Tiranë** (sipas lidhjes nr. 1), nuk janë në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji 138/2015. Rezultojnë të jenë të padënuar me vendim penal të formës së prerë.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkinë Tiranë të subjektit zgjedhor partia “Lëvizja Bashkë”. Referuar ligjit, nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose shtrojnë funksione publike”, i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, të subjektit zgjedhor partia “Lëvizja Bashkë” nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi të listës shumemërore të subjektit zgjedhor “Lëvizja Bashkë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 67, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenet 67, 72 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të

Data: 3.4.2023 Nr: 244
Ora: 16:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listës shumemërore, të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, të subjektit zgjedhor “Lëvizja Bashkë” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, dhe në nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, në Bashkinë Tiranë, të subjektit zgjedhor “Lëvizja Bashkë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Lëvizja Bashkë
Bashkia Tiranë

Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Mirela	Besjan	Ruko	02/10/1993	F
2	Redi	Fredi	Muçi	18/11/1985	M
3	Vitori	Petro	Çipi	16/02/1994	F
4	Oltion	Rako	Fociro	27/10/1981	M
5	Rexhina	Bujar	Elmazi	22/08/1994	F
6	Juljan	Sazan	Myftari	24/05/1982	M
7	Teuta	Faik	Memaj	01/10/1953	F
8	Elton	Rakip	Dervishi	01/06/1981	M
9	Fatma	Ramazan	Mesiti	22/03/1957	F
10	Demian	Dedë	Mrishaj	10/09/1998	M
11	Misuela	Mit'hat	Shimaj	17/08/1990	F
12	Enea	Egdi	Gramo	12/02/1993	M
13	Arsita	Fatos	Mati	10/01/1986	F
14	Dorjan	Pjeter	Myftari	13/12/1994	M
15	Adela	Aleks	Hoti	10/03/1998	F
16	Xhoni	Astrit	Merkohasanaj	21/11/1994	M
17	Stela	Fredi	Muçi	22/06/1992	F
18	Todi	Lili	Ndoni	01/03/1947	M
19	Rajmonda	Theodhor	Askushaj	11/07/1968	F
20	Luan	Ahmet	Saliaj	25/03/1979	M
21	Anxhela	Jetnor	Hoxha	04/11/2000	F
22	Jeton	Timoshenko	Pekmezi	17/05/1980	M
23	Geraldina	Ramadan	Mançka	05/11/2000	F
24	Elvjon	Gëzim	Meçani	20/04/1988	M
25	Albina	Besjan	Ruko	25/08/1996	F
26	Eno	Myzafer	Gupe	07/10/1991	M
27	Ledia	Maks	Dinoshi	15/12/2003	F
28	Albi	Romeo	Bushi	12/05/1988	M
29	Orjola	Rrapo	Shahinas	18/06/2003	F
30	Genci	Reshat	Gega	26/05/1989	M
31	Klevisa	Njazi	Hoxhaj	02/10/2000	F
32	Tarkan	Robert	Bashllari	23/10/2002	M
33	Marsela	Agim	Qokaj	23/04/2001	F
34	Ronald	Fiqiri	Kurti	12/05/1993	M
35	Kristiana	Frrok	Kola	05/12/2000	F
36	Jozi	Sokol	Gila	08/07/1997	M



Lëvizja Bashkë
Bashkia Tiranë

Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
37	Bora	Shkëlqim	Memaj	02/01/1993	F
38	Alfred	Kujtim	Berberi	21/01/1985	M
39	Loreta	Mhill	Koleci	26/06/2001	F
40	Enea	Engjëll	Islamaj	26/05/2000	M
41	Marie	Mark	Bushi	18/10/1963	F
42	Kevin	Myrteza	Dishani	09/07/1995	M
43	Xhuljana	Kujtim	Uku	16/02/2000	F
44	Redi	Arjan	Koçiaj	23/10/2001	M
45	Jonida	Xhelo	Kiçaj	12/11/1980	F
46	Elsad	Lirim	Lumaj	22/08/1999	M
47	Silvana	Merxhan	Palushi	20/03/1997	F
48	Augusti	Vehbi	Dalliu	07/06/1994	M
49	Violeta	Niko	Kromidha	15/11/1947	F
50	Besart	Sulejman	Latifaj	10/06/1985	M
51	Elsa	Ruzhdi	Bitri	01/05/1987	F
52	Alfred	Zef	Bushi	12/05/1984	M
53	Entela	Vasil	Koçiaj	17/06/1968	F
54	Elvis	Muhamet	Qori	16/05/1984	M
55	Esi	Agim	Zaimi	14/01/1998	F
56	Jetmir	Arben	Alku	10/08/1994	M
57	Flavia	Eduart	Osmani	11/07/2000	F
58	Geron	Halil	Mamica	07/04/2004	M
59	Lindiana	Perparim	Agolli	10/12/2001	F
60	Elios	Ilir	Shahini	30/09/2003	M
61	Gjulia	Altin	Marinaj	12/11/1998	F
62	Jani	Simo	Marka	20/04/1980	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

62

